



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I86-2

Prot.

Tiranë 4/11/2025

Nr. Dok. 202503687/

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë/Komisariatit e
Policisë Durrës

Drejtuar:

Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës

DURRËS

Komisariatit të Policisë Durrës

DURRËS

Për dijeni:

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Shtetit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatit e Policisë Durrës më datë 23.10.2025.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisariatit e Policisë Durrës.

Inspektimi u krye sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 82/2024¹ “Për Policinë e Shtetit”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit, u takua me Shefin e Komisarariatit z. Algert Gjonaj i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim Shefi i Komisarariatit informoi grupin e inspektimit mbi gjendjen e kushtet, në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit dhe i sigurisë në këtë komisarariat dhe informoi për masat e marra për plotësimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar², në lidhje me përmirësimin e disa kushteve sipas normave dhe standardeve, për qëndrimin dhe trajtimin e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, sipas përcaktimeve të bëra në aktet ndërkombëtare dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Grupi i inspektimit pasi mori informacionin e nevojshëm, i shoqëruar nga Shefi i Rendit vijoi me inspektimin e ambientit të shoqërimit dhe atij të sigurisë, për evidentimin e kushteve në të cilat janë ndërtuar dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë, plotësimin e kriterëve për ndërtimin e dhomave dhe rregullat që zbatohen nga personeli i shërbimit policor për respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të privuar nga liria.

¹ Ligji i ri nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, i cili ka hyrë në fuqi në datë 23.08.2024.

² Shkresë Nr.K4/I45-2, Prot., datë 06.09.2024, “Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Durrës”.

Nga informacioni dhe verifikimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të dërguara në përfundim të inspektimit të kryer në vitin 2024, rezulton se:

1. Ishin marrë masat pjesërisht, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar shtimin e dhomave të sigurisë me qëllim respektimin e kriterëve të hapësirës së nevojshme për jetesë për çdo person të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.
2. Ishin marrë masat pjesërisht, për eliminimin e lagështirës në ambientet e dhomave të sigurisë në Komisariatit të Policisë Durrës.
3. Ishin marrë masat pjesërisht, për lyerjen dhe dezinfektimin në mënyrë vazhdueshme të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë në Komisariatit të Policisë Durrës, me qëllim garantimin e kushteve higjieno-sanitare dhe pastërtisë në këtë institucion, si dhe zëvendësimin e materialeve hidrosanitare, në dhomat e sigurisë për të qenë sa më funksionale për persona të ndaluar/arrestuar në konflikt me ligjin.
4. Ishin marrë masat për asgjësimin e të gjitha medikamenteve të cilave iu ka kaluar afati i përdorimit dhe zëvendësimin e tyre me medikamente të reja.
5. Ishin marrë masat, për pajisjen me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin në ambientet e dhomave të sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës.
6. Ishin marrë masat për plotësimin me korrektësi të rubrikës “Njoftimi i familjarëve” tek Regjistri i personave të shoqëruar dhe evidentimin e tyre në këtë regjistër.
7. Ishte plotësuar rekomandimi për plotësimin me korrektësi të “Formularit të Raportit të Shoqërimit”, nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, në zbatim të rregullave të përcaktuara në procedurat standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

8. Ishin marrë masat nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar, brenda 12 orëve të vendosjes të këtyre personave në ambientin e sigurisë, qoftë edhe rastin që mjeku është me leje, persona të arrestuar/ndaluar, të dërgohen në Spitalin Rajonal Durrës. Sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.
9. Ishte plotësuar rekomandimi për afishimin në ambientet e dhomave të shoqërimit, të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluari/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokatët privatisht.
10. Ishte plotësuar rekomandimi për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisarariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut Tiranë.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

1. Nuk ishin marrë masat për parashikimin e kapaciteteve të dhomave të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, sipas parashikimeve të standardeve të hapësirës, si dhe miratimin me urdhër nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
2. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin më vete të dhomës së intervistimit të personave të shoqëruar dhe të dhomës për marrjen në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit audio-viziv në këto dhoma.
3. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për riparimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, ndalimit/arrestimit për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
4. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe për meshkuj, si dhe pajisjen e tyre me materialet e nevojshme hidrosanitare dhe vendosjen e bolierit për ngrohje të ujit, i cili është i domosdoshëm për

mbajtjen pastër të higjienës personale të personave të shoqëruar në këtë institucion.

5. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për vendosjen e tavolinave në dhomat e shoqërimit sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.
6. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin e ambienteve të ajrimit për personat në dhomat e sigurisë.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisaratin e Policisë Durrës, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisaratin e Policisë Durrës ambienti i shoqërimit, në përgjithësi ishte i ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurat standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*” miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Sipas informacionit të grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja konkrete e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Ambienti i shoqërimit përbëhej nga 4 (katër) dhoma shoqërimi të ndara më vete, nga të cilat 2 (dy) dhoma për mbajtjen dhe trajtimin e personave të rritur burra, 1 (një) dhomë për gra dhe 1 (një) dhomë për të mitur.

Dhomat e shoqërimit ishin me përmasa 5x3 m², me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve me kapacitet deri 15 persona, me kushte normale për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që iu njeh ligji këtyre personave.

Mjediset e dhomave të shoqërimit ishin të mirëmbajtura, dritaret në dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me skarë hekuri që lejonte ajrimin dhe ndriçimin natyral, ndërkohë dhomat kishin ndriçim edhe nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pajisura me stola druri me skelete metalike të fiksuara në dysHEME për qëndrimin ulur të shtetasve të

shoqëruar, por mungonin tavolinat për qëndrimin e personave në konflikt me ligjin në këto ambiente.

Dyert e dhomave të shoqërimit ishin prej druri, të cilat kishin mundësi për t'u mbyllur nga jashtë. Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej një tualet i përbashkët për meshkuj dhe femra, i pajisur me lavaman dhe çezmë me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Ndërkohë, sjellim në vëmendje se referuar procedurave standarde, ambienti i shoqërimit duhet të ketë dy tualete të ndara më vete për meshkuj dhe femra, siç parashikohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku parashikohet se: *“Brenda ambienteve të shoqërimit ose ngjitur me to, duhet të ketë tualete, të ndara më vete për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim”*³.

Në mjedisin dhe korridorin e shoqërimit ishin të instaluar kamera për monitorimin e veprimeve që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar përgjatë 24 orëve.

Gjatë inspektimit u evidentua se në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë si dhe në gjuhë të huaj, por ato mungonin brenda dhomave të shoqërimit, me qëllim që të jenë të aksesueshëm nga personat e shoqëruar për tu njohur me këto të drejta. Në momentin e inspektimit në ambientin e shoqërimit nuk kishte shtetas të shoqëruar.

Nga komunikimi me punonjësit e shërbimit në zyrën e informacionit, konstatuam se **mungonte kopja e kartës me të drejtat e cila ju jepet shtetasve në momentin e hyrjes në dhomat e shoqërimit.**

Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me *“Kartën e të drejtave”* në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisarjat policie. Nëpërmjet *“Kartës së të drejtave”* qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.

“Karta e të Drejtave” i shërben jo vetëm qytetarit, por edhe vetë Policisë së Shtetit, për të mirëmbajtur besimin e qytetarëve tek ajo, për ta forcuar bindjen se ajo është një

³ Kreu VI, pika 4 germa “e.2” e procedurave standarde të punës *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”* parashikon se: *“Pranë dhomave të shoqërimit dhe ngjitur me to ndërtohen dhe funksionojnë tualetet për kryerje të nevojave personale të ndara për femra dhe meshkuj, me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve përkatëse dhe funksionimin për qëllimin që kanë, me sipërfaqe 6 – 8 m²”*.

instrument profesional shërbyes dhe jo dhunues i qytetarëve, si dhe për të evidentuar e veçuar abuzuesit me uniformën e policisë.

Vendosja në dispozicion të çdo qytetari të “*Kartës së të Drejtave*” është një standard të cilin Avokati i Popullit kërkon vazhdimisht që të respektohet.

Në Komisariatit të Policisë Durrës, gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 23.10.2025 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit 2122 persona, ndër të cilët 98 shtetas gra dhe 83 të mitur në konflikt me ligjin.

Nga inspektimi i ambientit të shoqërimit u konstatua se, mungonte dhoma e veçantë për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar, e cila duhet të jetë e pajisur me tavolina, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orënditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë⁴, dhe për këtë arsye sipas informacionit të Shefit të Rendit, të shoqëruarit merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Në strukturën organike të Komisariatit të Policisë Durrës janë 13 specialistë policie, që kryejnë funksionin e OPGJ-së për rastet e hetimit të veprave të rënda penale dhe njëkohësisht ata kryejnë veprimet procedurale të marrjes në pyetje të personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar. Në këtë institucion kishte 13 zyra pune të OPGJ-ve dhe nga inspektimi i këtyre zyrave, nuk u gjendën sende apo mjete që ekspozojnë dhunë te personat e shoqëruar gjatë intervistimit apo marrjes në pyetje të tyre.

Gjithashtu, në katin e parë të Komisariatit të Policisë Durrës, ndodheshin 2 zyra të cilat shërbenin si zyra pune për Specialistin e Policisë së Zonës (SPZ). Këto ambiente ishin të pajisura me tavolina, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orënditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë, por nuk kishte të instaluar kamerat e monitorimit⁵.

Në katin e dytë të Komisariatit të Policisë Durrës, gjatë inspektimit, u evidentua se ishte krijuar një mjedis i ri i quajtur “*Hapësirë miqësore për fëmijët*”, që shërbente për intervistimin apo marrjen në pyetje të personave të mitur në konflikt me ligjin. Ky ambient, përbëhej nga 3 dhoma të kompletuara me pajisje dhe orënditë e nevojshme për mbrojtjen dhe trajtimin dinjitoz të të miturit, viktimë e një veprë penale, gjatë procesit të hetimit.

⁴ Kreu VI, Pika 3/d e procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*” miratuar me Urdhrin Nr.894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

⁵ Kreu VI, Pika 4/g e procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në Komisarlatin e Policisë Durrës, kishte një magazinë më vete e cila shërbente si dhomë e marrjes së provave materiale dhe sipas informacionit të drejtuesve të komisarlatit provat materiale futen në një qese të etiketuar në këtë ambient⁶.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisarlat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në kapitullin VIII, pika a.3.4⁷ të procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* miratuar me Urdhrin nr.894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Gjithashtu, u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisarlatin e Policisë Durrës, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Durrës, ambienti i sigurisë ishte i ndërtuar pjesërisht sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar dhe procedurat standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin nr. 1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në këtë ambient ndodheshin 8 (tetë) dhoma sigurie, nga të cilat 6 (gjashtë) dhoma për meshkuj madhorë, 1 (një) për gra dhe 1 (një) për të mitur. Kapaciteti zyrtar i dhomave të sigurisë ishte për trajtimin dhe sigurimin e 8 (tetë) personave të arrestuar/ndaluar, sipas procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin nr. 1720, datë 20.11.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Dhomat e sigurisë janë të organizuara në dy ambiente, në ambient qëndrimi dhe në paradhomë, të ndara me njëra-tjetrën me një skarë hekuri dhe derë që mbyllet me çelës,

⁶ Neni 215 i Kodit të Procedurës Penale *“Vulosja e sendeve të sekuestruara”*.

⁷Urdhër nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e Policisë”* a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: a.3.4 ku parashikohet se: *“Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimit personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore”*.

në ambientin për jetesë, si dhe në paradhomën që shërbente për qëndrimin e personave në orare të caktuara dhe për pastrim vetjak.

Të 8 dhomat e sigurisë të pajisura me nga një shtrat, i plotësonin normat dhe parametrat teknik jetësor, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 m², e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².

Nga këqyrja e regjistrit për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, për periudhën 01.01.2025 - 23.10.2025, ishin evidentuar në këtë regjister 660 persona, nga të cilët saktësisht 3 shtetas të mitur dhe 31 shtetase gra të ndaluar/të arrestuar në konflikt me ligjin.

Referuar këqyrjes së këtij regjistri u evidentua se në disa raste ka pasur situatë të mbipopullimit apo rasteve të personave që flenë në tokë. Grupi i inspektimit konstatoi se në disa dhoma të sigurisë përveç dyshekut të vendosur në krevat kishte dhe nga një dyshek tjetër, ku në rast të mbipopullimit personat flinin në dyshek të vendosur në tokë, duke përbërë **trajtim jo dinjitoz të tyre**⁸.

Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar edhe në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e Komitetit për Parandalimin e Torturës në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023, i cili ka rekomanduar se: ***“Autoritetet shqiptare duhet të marrin masat e nevojshme për të garantuar respektimin e kapaciteteve zyrtare të ambienteve të ndalimit të policisë”***.

Në ambientin e paradhomës ishte i instaluar një lavaman së bashku me rubinetin e ujit, si dhe tualeti i vendosur në dysheme. Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla, që mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të dritës natyrale. Çdo dhomë ishte e pajisur me orënditë e nevojshme për jetesë si krevat, dyshekë, bataniye dhe jastëk, të cilat ishin në gjendje të mirë dhe të pastra.

Larja e bataniyeve dhe ndërrimi i materialeve të vjetërsuara apo dëmtuara që shërbenin për fjetje në dhomat e sigurisë, kryhej periodikisht, sipas një grafiku të miratuar nga struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Policisë Durrës.

Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në rast nevojë. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për përdorim nga punonjësit e shërbimit në rastet e

⁸ Normat dhe parametrat teknike, jetësore e të sigurisë së dhomave për një të arrestuar/ndaluar janë: Sipërfaqe e përgjithshme jo më pak se 10 metër katror, e cila ndahet në ambient qëndrimi (dhoma) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m². Lartësia e këtyre ambienteve është jo më pak se 2.5 m.

tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Ambienti i sigurisë kishte burim rezervë energjie me gjenerator më vete.

Në ambientet e sigurisë ishte instaluar sistemi ngrohje/ftohje me sistem qendror kalidajë, por ishte jashtë funksionit duke mos përmbushur standardet që parashikohen në procedurat për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, ndërsa për periudhën e dimrit institucioni kishte siguruar pajisje elektrike, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larjen e trupit në një ambient të posaçëm (1 dush me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në korridor. Dushet ishin funksionale dhe punonin me sistem qendror dhe po ashtu në paradhomën e dushëve kishte tualet të përbashkët, i cili ishte i pajisur me të gjitha pajisjet që shërbejnë për këtë qëllim.

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhoma për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige, si dhe me frigorifer për ruajtjen e ilaçeve të emergjencës, të cilat kërkojnë të mbahen në kushte frigoriferike. Në një raft, mbaheshin kartelat mjekësore me dinamikën e vizitave mjekësore për çdo person të ndaluar/arrestuar. Nga këqyrja e regjistrit të mjekut vërejmë se ishte plotësuar në çdo rubrikë për evidentimin e të dhënave shëndetësore për personat që ju privohet liria në ambientet e këtij komisariati.

Në këtë ambient ndodhej një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët, e cila shërbente dhe për marrjen në pyetje të këtyre personave nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave që merren në pyetje, por nuk kishte kamera për mbajtjen në vëzhgim të veprimeve që kryejnë oficerët e policisë gjyqësore me të ndaluarit/arrestuarit dhe anasjelltas për të parandaluar çdo veprim të mundshëm të këtyre personave.

Trajtimi shëndetësor për persona të ndaluar/arrestuar, kryhet nga mjeku që është i punësuar me kohë të plotë në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës. Për trajtime shëndetësore më të specializuara, me rekomandimin e mjekut, personat e ndaluar/arrestuar shoqërohen menjëherë për në Qendrën Spitalore Rajonale Durrës.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me sistemin e kamerave përgjatë 24 orëve. Ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë 30 ditore.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve në ambientet e sigurisë

Në kohën e inspektimit, në ambientet e sigurisë ndodheshin 8 persona të ndaluar/arrestuar në pritje të vlerësimit të masave të sigurisë nga gjykata.

Nga intervistat me personat e arrestuar/ndaluar, ata nuk paraqitën asnjë ankesë për keqtrajtime nga punonjësit e policisë gjatë procesit të marrjes në pyetje, si dhe nga punonjësit e shërbimit në ambientin e sigurisë.

Nga verifikimi i librit të ankesave dhe kërkesave, u evidentua se nuk kishte asnjë ankesë apo pretendim për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike nga punonjësit e policisë.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në vendimin nr. 189, datë 15.03.2017 *“Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”*. Ushqimi përgatitej dhe shërbehej nga një subjekt privat që ushtronte aktivitetin brenda territorit të Komisarariatit të Policisë Durrës.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Gjithashtu, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës nuk ka ambiente ajrimi për persona të ndaluar/arrestuar siç parashikohet në Kreun VI, pika 1.14 të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023 *“Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, ku thuhet se: *“Personi i ndaluar/arrestuar mund të dalë në ajrim sipas mundësive dhe kushteve që kanë ambientet e dhomave të sigurisë, por jo më pak se dy orë në ditë (për ato ambiente sigurie që nuk plotësojnë kushtet për ajrim e ndriçim të plotë natyral)”*.

Në vijim, nga intervistat me personat e arrestuar që ndodheshin në momentin e inspektimit, u evidentua se ishin furnizuar me detergjente, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqirë e mjete të tjera nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, si kusht për mbajtjen pastër të higjienës personale, ambientit të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisariatin e Policisë Durrës “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1”, sipas procedurave standarde “Rregullat teknike

të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili mbahej në zyrën e informacionit dhe ishte i sekretuar e i plotësuar sipas rubrikave.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024, “*Për Policinë e Shtetit*” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, regjistri ishte i sekretuar dhe rubrikat e tij ishin plotësuar nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 5 orë në raste të veçanta. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson uljen e kohës së ndalimit të përkohshëm, në Ligjin e ri për Policinë e Shtetit nr.82/2024, i cili fillon që në momentin kur punonjësi ndalon personin dhe zgjat deri në sqarimin e çështjes, por **në asnjë rast më shumë se 5 orë.**

Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit këqyri disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisariatit të Policisë Durrës, u konstatua se “Procesverbalet e Shoqërimit”, ishin të plotësuara në të tëra rubrikat e tij.

Në procedurën Standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, përcaktohet qartë në kreun VII, pikat a.2.1 – Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, menjëherë pas shoqërimit të personit në ambientet e policisë/ambientet e shoqërimit.

Ndërkohë, u konstatua se në këtë komisarariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar. Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, nuk rezultoi të kishte raste apo pretendime të evidentuara për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike, nga punonjësit e policisë të komisarariatit.

Në këtë komisarariat kishte regjistër më vete për evidentimin e të dhënave të të miturve në konflikt me ligjin i cili ishte plotësuar në rregull dhe evidentuar sipas procedurës.

Avokati i Popullit thekson se plotësimi i regjistrit në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor me funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Ambientet e intervistimit

Në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Durrës kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës, e cila shërbente

njëkohësisht dhe për takim me avokatët. Kjo dhomë nuk ishte e monitoruar nga sistemi i kamerave.

Shtetasit e shoqëruar, para se të ndaloheshin apo arrestoheshin dhe të futeshin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Në lidhje me ambientet e intervistimit, Avokati i Popullit në zbatim edhe të rekomandimeve të KPT-së, ka rekomanduar në vijimësi marrjen e masave për krijimin e zyrave për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente. Nga inspektimet periodike që zhvillon MKPT-ja në Drejtoritë dhe Komisariatet e Policisë, konstatohet se ky rekomandim nuk është plotësuar⁹.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar të arrestuar/ndaluar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, nga punonjësit e policisë së si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ndaj tyre.

Gjithashtu, në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit¹⁰ ku citohet se: *“Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.*

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në

⁹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”.

¹⁰ Electronic recording of police interviewees (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare”.

KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Në Komisariatit e Policisë Durrës, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit” si dhe në Kreun VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Sipas informacionit, përgjithësisht avokati paraqitej në mjediset e policisë jo më vonë se 3 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët e policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në regjistrin ku evidentohen takimet e të arrestuarit me avokatin mbrojtës, shënohej emri dhe mbiemri i avokatit, si dhe ora e takimit, por jo ora e njoftimit.

Përgjatë inspektimit në Komisariatit e Policisë Durrës, u konstatua se nuk kishte një listë të afishuar në ambientet e komisarariatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht, si dhe nuk ishte evidentuar në regjistrin e informacionit nëse avokatët kishin qenë të pranishëm. Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

KPT-ja bën rekomandime të hartuara për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Gjithashtu kërkohet veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. KPT-ja gjatë vizitës në organet e Policisë së Shtetit ka konstatuar se: *“Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat kryesisht vetëm pas një vonese*

të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t'i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati”¹¹.

Përgjatë inspektimit punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Gjithashtu, u evidentua se në mjedisin e shoqërimit ishte afishuar lista e psikologëve e miratuar nga Urdhri i Psikologut në Tiranë. Pavarësisht kësaj, në rastet kur i shoqëruari apo i ndaluar/arrestuari ishte i mitur, psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, por edhe në bashkëpunim me Bashkinë dhe Shkollën e Mesme në qytetin e Durrësit. Mekanizmi Kombëtar kërkon që avokati dhe psikologu të jenë të pranishëm, që në momentin e hyrjes të të shoqëruarve në komisarjat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre dhe mbështetje psikologjike në rrethanat në të cilat këta shtetas ndodhen në institucion.

Grupi i monitorimit konstatoi se, vizitat mjekësore nga ana e mjekut kryheshin brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”¹².*

Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur posterat me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në shqip dhe në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Nga radhët e punonjësve të policisë të këtij komisarjati, ishin trajnuar dhe specializuar 2 punonjës policie që administronin dhe asistonin procesin e drejtësisë penale për të mitur.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi;

¹¹ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

¹² Kreu V, pika 7.2 e procedurave standarde *“Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për parashikimin e kapaciteteve të dhomave të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, sipas parashikimeve të standardeve të hapësirës, si dhe miratimin me urdhër nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
2. Marrjen e masave për krijimin më vete të dhomës së intervistimit të personave të shoqëruar dhe të dhomës për marrjen në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit audio-viziv në këto dhoma.
3. Marrjen e masave për riparimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, ndalimit/arrestimit për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
4. Marrjen e masave për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe për meshkuj, si dhe pajisjen e tyre me materialet e nevojshme hidrosanitare dhe vendosjen e bolierit për ngrohje të ujit, i cili është i domosdoshëm për mbajtjen pastër të higjienës personale të personave të shoqëruar në këtë institucion.
5. Marrjen e masave për vendosjen e tavolinave në dhomat e shoqërimit sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.
6. Marrjen e masave për dhënien e kartave të të drejtave personave të shoqëruar në momentin e hyrjes në komisariat në formë shkresore, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore / procedurale që personat e shoqëruar kanë.
7. Marrjen e masave për afishimin brenda dhomave të shoqërimit me posterat me të drejtat e personave të shoqëruar.
8. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve të ajrimit për personat në dhomat e sigurisë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI

d.v